



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 2563/1 prot.

Tiranë më 13.12.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin “Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Bangladeshit mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 12035/2 prot., datë 6.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 2563 prot., datë 6.12.2024 me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Bangladeshit mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit dhe relacionit shoqërues vërejmë se palë në këtë projekt marrëveshje është Republika Popullore e Bangladeshit.

Fillimisht, Zyra e Komisionerit ju informon se, pika 1, e nenit 8, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), përcakton se, “Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendim të Komisionerit”.

Në vijim, në zbatim të Ligjit, si dhe *Vendimit Nr.8 datë 31.10.2016* dhe *Udhëzimit Nr.41 datë 13.06.2014* të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale konstatojmë se, Republika Popullore e Bangladeshit, nuk bën pjesë në kategorinë e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Për rrjedhojë, referuar nenit 8 pika 2, dhe nenit 9, pika 3 të Ligjit, çdo veprim i shkëmbimit të informacionit, pjesë e së cilit gjenden të dhëna personale, konsiderohet si transferim ndërkombëtar i të dhënave për të cilat nuk kërkohet autorizim.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë nivelin e pamjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale në Republikën Popullore të Bangladeshit, Zyra e Komisionerit sugjeron si më poshtë vijon:

Në përmbajtje të nenit 1, të Projekt-Marrëveshjes “*Përkufizime*”, sugjerojmë të përfshihet edhe përkufizimi i termit “*të dhëna personale*”, sipas përcaktimit të Ligjit 9887.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, kategoritë e të dhënave që do të shkëmbehen midis palëve, duhet të identifikohen në mënyrë konkrete, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e legjislacioneve respektive nga autoritetet përgjegjëse, si dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave personale, të parashikuar në nenin 5/1/c të Ligjit, i cili përcakton se, të dhënat e grumbulluara, duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

Për sa më sipër, sugjerojmë që neni 16, të riformulohet, sipas përmbajtjes në vijim:

Neni 16

Përpunimi i të dhënave personale

- 1. Të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të palëve.*
- 2. Të dhënat personale duhet të mblidhen dhe përpunohen vetëm për qëllimin e specifikuar, të qartë dhe të ligjshëm në këtë marrëveshje dhe nuk përpunohen më tutje nga autoriteti komunikues, as nga autoriteti marrës në një mënyrë të papajtueshme me këtë qëllim;*
- 3. Palët, në rast transferimi ndërkombëtar të të dhënave personale duhet të shkëmbejnë të dhëna personale në përputhje me qëllimin e grumbullimit të tyre, si dhe duhet të ndërmarrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çfarëdo forme tjetër e paligjshme përpunimi.*

4. *Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen për qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje janë si më poshtë:*
 - *Të dhënat personale të personit që do të ripranohet ose kalojë tranzit; (emër, mbiemër, emra të mëparshëm, emrat e tjerë të përdorur me të cilat njihet apo aliase, gjinia, gjendja civile, datëlindja, vendlindja, shtetësia aktuale dhe shtetësitë të tjera);*
 - *Pasaporta, mjete identifikimi (ID, Leje drejtimi e automjetit);*
 - *Vendqëndrimet dhe itineraret e udhëtimit;*
5. *Të dhënat personale duhet të mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave, por jo më gjatë sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin të dhënat janë mbledhur, ose për të cilat ato përpunohen më tej;*
6. *Si autoriteti komunikues, ashtu edhe autoriteti marrës duhet të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të siguruar saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen si dhe duhet të ndërmerret çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej;*
7. *Sipas kërkesës, autoriteti kompetent marrës do të informojë autoritetin kompetent komunikues mbi përdorimin e të dhënave të marra prej tyre;*
8. *Të dhënat personale mund ti komunikohen vetëm autoriteteve kompetente. Komunikimi i mëtejshëm tek organet e tjera kërkon pëlqimin paraprak të autoritetit komunikues;*
9. *Palët në këtë marrëveshje kanë detyrimin për të dokumentuar me shkrim të dhënat gjatë komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave personale.*

Nga shqyrtimi në tërësi i tekstit të projekt-marrëveshjes, rezulton se për zbatimin efektiv dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, është e nevojshme të shtohet një nen lidhur me specifikimet konkrete mbi transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, duke marrë parasysh faktin që Republika Popullore e Bangladeshit konsiderohet si vend me nivel të pamjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, si më poshtë vijon:

Neni 17

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale

1. *Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të palëve.*
2. *Transferimi i ndërkombëtar i të dhënave personale mund të lejohet vetëm në rastet e mëposhtme:*
 - a) *Kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin;*
 - b) *Është detyrim ligjor i kontrolluesit;*
 - c) *Për të mbrojtur interesat legjitim të subjektit të të dhënave, kur legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale të palës që dërgon, e lejon këtë transferim;*

- d) *Për të shmangur një kërcënim serioz dhe të menjëhershëm për sigurinë publikë kur legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale të palës që e dërgon, e lejon këtë transferim;*
 - e) *Është i nevojshëm apo përbën një kërkesë ligjore për një interes të rëndësishëm publik ose për ushtrimin dhe mbrojtjen e një të drejte ligjore;*
 - f) *Për të mbrojtur një interes jetësor të subjektit të të dhënave.*
3. *Secila palë duhet të garantojë mbrojtjen e të dhënave personale me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshje, duke marrë përsipër detyrimin për të mos i transferuar të dhënat personale të marra, tek palët e treta, dhe në çdo rast të mos i përpunojë ato, pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.*

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, kjo projekt-marrëveshje do të konsiderohet e hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi